LIGJ
Nr.9845, datë 17.12.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9584, DATË 17.7.2006 "PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika 1, pas fjalëve "Këshilli i Lartë i Drejtësisë" shtohen fjalët "Avokati i Prokurimeve".

Neni 2

Në lidhjen nr.1, që përmendet në nenin 4, bëhen këto ndryshime:
a) në klasifikimin "F", pika 5 shfuqizohet;

b) në klasifikimin "E", pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
"4. Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës 0,55".

c) në klasifikimin "d", pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:
"9. Avokati i Prokurimeve 0,6".

Neni 4
Dispozitë kalimtare

Për Avokatin e Prokurimeve, ky ligj i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5567, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi